



PROGRAMI I BIZNESEVE TË GJELBËRTA

Nëntor 2025

KONKURSI I BIZNESEVE TË GJELBËRTA

Konkursi i Bizneseve të Gjelbërta është një aktivitet që organizohet nga Partnerët Shqipëri që prej vitit 2012. Ai synon të stimulojë e inkurajojë inovacionin për ide biznesi të gjelbërta në nivel lokal dhe të hulumtojë rolin e filantropisë në angazhimin e komuniteteve lokale për të gjeneruar ide biznesi të bazuara në shfrytëzimin e burimeve lokale, ringjalljen e traditave të prodhimit dhe tregjeve lokale.

Përmes mbështetjes së nismave inovatore që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik lokal, Konkursi i Bizneseve të Gjelbërta synon të kontribuojë në mënyrë thelbësore në ndërtimin e një rajoni të begatë, konkurrues dhe të paqetë të Ballkanit Perëndimor dhe Greqisë, në përputhje me nëntë (9) Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës 2030.



Partnerët Shqipëri ofron shërbime inkubimi dhe përsheptimi (akselerimi) në mbështetje të start-up-eve dhe sipërmarrjeve sociale të gjelbërta, në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, mentorimin për ofrimin e ideve të biznesit, mundësi rrjetëzimi, ekspozim ndaj tregjeve ndërkombëtare, si dhe financim në kapital fillestar. Financimi ofrohet nëpërmjet fondeve të ngritura si përpjekje e institucioneve filantropike, donatorëve, si dhe kontribute të bizneseve vendase. Donatorët kryesorë me ndikim social përgjatë viteve kanë qenë: Rockefeller Brothers Fund, Credins Bank, Telekom Albania, OneTelecommunications, Tirana Bank, Erasmus+, The Balkan Trust for Democracy.



Ide të gjelbërta

-  + 140 sipërmarrës kanë përfutur trajnim dhe mentorim
-  49 SS kanë përfutur mbështetje, 28 janë aktive
-  Punësim i drejtpërdrejtë për më shumë se 70 individë
-  7 herë fitues shqiptarë në Konkursin Rajonal të Ideve të Gjelbërta

MBËSHTETJA

Përgjatë dy ditëve që zgjat konkurrimi, finalistët e përzgjedhur mes konkurrentëve nga organizata jofitimprurëse, sipërmarrje sociale, biznesi i vogël në vend dhe individë, prezantojnë ide të tyre para një jurie të pavarur me ekspertë të fushës së ekonomisë, edukimit dhe zhvillimit të biznesit.

Konkursi mbështet ide biznesi në dy fasha kryesore, sipas maturimit të idesë:

Fasha 1: Ide biznesi në fazë konceptuale

Fasha 2: Biznes në fazat e para të zhvillimit

Tre fitues në nivel kombëtar, bëhen automatikisht pjesë e konkurrimit në Konkursin Ballkanik të Ideve të Gjelbërta, bashkë me fituesit e konkurseve kombëtare nga Kosova, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnjë Hercegovina.

KËRKIMI



Partnerët Shqipëri ofron kontributin e saj në kërkimin dhe advokimin, veçanërisht në lidhje me kuadrin ligjor të sipërmarrjeve sociale. PSh ka qenë pioniere në fushën e kërkimit për sipërmarrjet sociale në Shqipëri, duke mbuluar çështjet si hartëzimi i sektorit, sfidat dhe mundësitë e tregjeve vendase, financimi ekzistues dhe mbështetja institucionale, potenciali për rritje, si dhe roli i aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë në zhvillimin e sipërmarrjes sociale.


Partnerët Shqipëri ka qenë pjesë e disa nismave kërkimore mbi sipërmarrjet sociale dhe sektorin në Ballkanin Perëndimor. Gjetjet kërkimore përbëjnë bazën e advokimit në nivel kombëtar dhe evropian, të mbështetur nga pjesëmarrja në rrjete të ndryshme si EMES, EUCLID, Balkan Social Enterprise Research Network, Diesis, etj.

Për sa i përket kërkimit në lidhje me sipërmarrjet e gjelbra, Partnerët Shqipëri ka kontribuar në zhvillimin e "Udhërrëfyesit të Ekosistemit të Sipërmarrjes së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor".

FITUESIT PËRGJATË VITEVE

Që prej vitit 2012, 49 sipërmarrje sociale të gjelbërta janë mbështetur nëpërmjet Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta, nga të cilat, 29 janë ende aktive në treg.

	2015	
	• '4 sy për natyrën', në Divjakë - Karavasta, Nartë, Valbonë	6
	2016	
	• 'Ferma Eko-Sociale', në Oblikë (Shkodër)	7
	• 'Kultivimi i shafranit', në Daias (Tiranë)	8
	• 'Komani flet!', në Koman	9
	2018	
	• 'Aloe Vera Albania', në Tiranë	10
	• 'Shtigje të gjelbërta', në Përmet	11
	2019	
	• 'Pemla', në Tiranë	12
	• 'Tryeza e shijes', në Tiranë	13
	• 'Pedalo në Belsh', në Belsh	14
	2020	
	• 'Margjelo Filigran Albania', në Shkodër	15
	• 'Rinora Handmade', në Kuç (Berat)	16
	• 'Vaji i lajthisë', në Gramëz (Thumanë)	17
	• 'Kroi i Mjaltit', në Shullaz (Kurban)	18
	2021	
	• 'Romix Community Toys', në Tiranë	19
	• 'Thesaret e Shijeve të Përmetit', në Përmet	20
	• 'Turi i lajthive', në Mallakastër	21
	2022	
	• 'Shebenik Egnatia Explorers', në Librazhd	22
	• 'Funky Cabins Glamping', në Çekrez (Tiranë)	23
	• 'Belsh Smart City', në Belsh	24
	• 'Lika Api-turizëm', në Sebisht (Librazhd)	25
	2023	
	• 'Purteka. Kopshtaria për fëmijë', në Vlorë	26
	• 'Amëza e Dheut' në Lezhë	27
	• 'Mjedrat e Danjës' në Vaun e Dejës	28
	• 'Reality Escapers Albania' në Vlorë	29
	• 'Trendy Traditë' në Vaun e Dejës	30
	2024	
	• 'Ferma e kërpudhave', në Bilisht (Korçë)	31
	• 'Agalma Sustainable Souvenirs', në Vlorë	32
	• 'Shebenik Egnatia Explorers' (zgjerim), në Librazhd	33
	• 'Mjedrat e Danjës' (zgjerim), në Vaun e Dejës	34
	2025	
	• 'Pure Recall', në Vlorë	35
	• 'Green Sound Space', në Tiranë	36
	• 'Green Energy', në FierShegan (Lushnjë)	37
	• 'Vlora Kayaking', në Vlorë	38



4 SY PËR NATYRËN

aos.alb

AOSALB

aos-alb.org



Ideja “4 Sy për Natyrën” e Shoqatës Ornitologjike të Shqipërisë (AOS) promovon ‘Birdwatching’ - pasionin për të kundruar shpendët- si një degë e re e eko-turizmit, e cila ndihmon në rivitalizimin e ekonomisë lokale të zonave natyrore të mbrojtura, duke u mbështetur edhe në traditën lokale të mikpritjes dhe kulinarisë.

AOS ka hartuar dhe vënë në dispozicion të turistëve 4 paketa turistike të gjelbërta që mbulojnë zonën e Divjakë - Karavastasë, Salinë-Nartës, Valbonës, dhe prej 2017 edhe Liqenin e Prespës në jug të Shqipërisë.



Si rezultat i bashkëpunimit me kompani të njohura udhëtimi dhe operatorë turistikë, si dhe falë një fushate të gjerë promovimi, Shqipëria është përfshirë tashmë në listën e destinacioneve për vizitorët e interesuar në këtë lloj turizmi.

Rreth 150 vizitorë në vit marrin pjesë në ekoturet e organizuara nga AOS, nga të cilat përfitojnë edhe 14 ofrues lokalë të shërbimeve të akomodimit dhe kulinarisë.



4

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

4

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

5

BASHKËPUNIME

AGRO-TURIZMI

FERMA

EKO-SOCIALE



thedooralbania

[The Door Albania](http://TheDoorAlbania)

infothedoor.com



Ferma Eko-sociale është ngritur në fshatin Oblikë, Ana e Malit në Shkodër dhe menaxhohet nga organizata The Door.

Një numër i konsiderueshëm turistësh vendas e të huaj, përdorues të biçikletave, motoçikletave dhe kamperave e të apasionuar pas natyrës që kalojnë përgjatë rrugës nacionale, e vizitojnë këtë zonë e cila ofron atraksione të shumta natyrore e kulturore.

Nëpërmjet mbështetjes së fondit, organizata ofroi trajnim për 22 persona me aftësi ndryshe, anëtarë të bandës muzikore e cila performon për vizitorët gjatë aktiviteteve kulturore që zhvillohen në amfiteatrin e Fermës.

Organizata ka punësuar 2 punonjës me kohë të plotë (persona të rrezikuar nga përjashtimi social), 3 persona me kohë të pjesshme nga familje me të ardhura të pakta dhe ka angazhuar 10 vullnetarë për ofrimin e shërbimeve të kampingut për rreth 1,500 turistë vendas e të huaj që vizitojnë Fermën çdo vit. 3 biznese lokale mbështesin Fermën duke ofruar produkte dhe shërbime kulinarie. Ferma ofron gjithashtu një infrastrukturë të përshtatshme për akomodimin në çadra, grila familjare, shëtitje me biçikleta, guida në vendet atraktive rreth fermës, etj.



2

PUNËSIM I DREJTPËRDREJTË

2

PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

3

PUNËSIM ME KOHË TË PJESSHME DHE VULLNETAR

4

BASHKËPUNIME

KULTIVIMI I SHAFRANIT

[bletashafran](#)

[Bletashafran](#)



Kultivimi i shafranit po zbatohet nga Fiqiri Guxha, mësues dhe agronom në fshatin Daias (pranë Tiranës). Pasioni për agronominë e ka shtyrë të testojë e kultivojë kultura të ndryshme bujqësore edhe gjatë kohës që nuk punonte më në këtë sektor.

Në këtë zonë mungojnë iniciativat e vetëpunësimit nëpërmjet prodhimit të kulturave bujqësore. Gjithashtu, vendndodhja pranë Tiranës dhe panorama e këndshme, ka tërhequr vëmendjen e shumë kompanive të ndërtimit të cilat synojnë të ndërtojnë aty resorte, duke shkatërruar natyrën.

Prej vitit 2016, sipërmarrja po punon për përgatitjen e tokës në kushte të përshtatshme për kultivimin e shafranit. Kultivimi i kësaj kulture të re me vlera të larta ushqyese dhe kuruese është tërësisht bio pasi nuk përdoren pesticide apo elementë të tjerë të rrezikshëm për tokën e shëndetin.

Fillimisht u trajnuan dhe punësuan 6 gra dhe burra nga zona, të përfshirë në të gjithë procesin e kultivimit të shafranit, që nga mbjellja e tij e deri në paketim. Kjo nismë ka inkurajuar edhe 5 fermerë të tjerë nga zona, të cilët po konsiderojnë kultivimin e shafranit në tokat e tyre, duke stimuluar në këtë mënyrë zhvillimin ekonomik të zonës.




KOMANI FLET!

[cospeonlus](#)

[cospeonlus](#)

[cospeonlus](#)



Kultura e Komaniit u gjurmua që në vitin 1898 nëpërmjet zbulimit të një varreze të madhe, pranë Kalasë së Dalmacës në Koman e më pas me zbulimin e rreth 30 varrezave të ngjashme, të përhapura kryesisht në Shqipërinë e Veriut e në atë të Mesme. Prej kohësh vazhdojnë gërmimet arkeologjike që dëshmojnë historinë e këtij vendi.

Qytetërimi arbëror i Komaniit është një pasuri shumëdimensionale pasi aty ka arkeologji, natyrë të pasur, miniera të vjetra të bakrit të cilat mund të rikthehen të vizitueshme. Ai përbën një aset të jashtëzakonshëm për ekonominë e vendit si edhe shumë i rëndësishëm si model qytetërimi për botën.

Organizata Cospe po punon për promovimin e kësaj trashëgimie historike, kulturore dhe natyrore përmes turizmit të përgjegjshëm.



Cospe ka realizuar shenjëzimin e 8 shtigjeve për turistët të cilat evidentojnë pasuritë e zonës, kishat, banesat e mjedisin e mrekullueshëm natyror, duke e lidhur këtë destinacion edhe me zona të tjera si Valbona apo Sarda. Gjithashtu, është ndërtuar dhe vënë në dispozicion të turistëve të interesuar edhe një aplikacion për celularë, ku gjenden shtigjet për ecje si dhe atraksionet e Komaniit.



Që prej fillimit të zbatimit të kësaj nisme, 10 familje nga zona kanë përshtatur shtëpitë e tyre në bujtina, bare dhe restorante për të ofruar shërbimet e akomodimit dhe kulinarisë për turistët.

15 të rinj nga Komanit të cilët u trajnuan si guida, shoqërojnë rreth 300 turistë që vizitojnë zonën në vit, duke u treguar për historinë e kulturën e këtij qytetërimi.

ALOE VERA ALBANIA

aloeveraalbania



Aloe-Vera-Center-of-Albania



Sipërmarrja është ngritur nga Albi Sulo dhe ka të bëjë me kultivimin e bimës Aloe Saponaria (ndër iniciativat e para të kultivimit të kësaj bime në Shqipëri) në një zonë periferike të Tiranës, me synimin për ta kthyer atë në një sipërmarrje të suksesshme dhe fitimprurëse.

Rajonet perëndimore dhe jug-perëndimore shqiptare janë të përshtatshme për kultivimin e kësaj kulture të re, për efektet që ajo ka dhe përfitimet financiare që sjell shitja e bimëve ose xhelit.



Kjo nismë inovatore lokale pritet të jetë një impuls nxitës për kultivimin më të gjerë të kësaj agrikulture të re bujqësore mjeksore në Shqipëri, duke shërbyer për përdorimin sa më të gjerë të tokës, rritjen e punësimit dhe mirëqenies. Sipërmarrja ka zgjeruar gamën e produkteve, duke përfshirë edhe lloje të ndryshme të bimës Aloe Vera dhe kompozimeve të ndryshme të saj.



3

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

+55

BASHKËPUNIME

SHTIGJET E GJELBËRTA

[rafting_vjosa_explorer](https://www.rafting_vjosa_explorer.com)

[Vjosa-Explorer](https://www.vjosa-explorer.com)

[vjosa-explorer.business.site](https://www.vjosa-explorer.business.site)



Ideja e Shoqatës Vjosa Explorer synon rritjen e ofertës turistike në rrethin e Përmetit përmes ndërtimit të Shtigjeve të Gjëlberta, si një potencial i pashfrytëzuar që përmirëson përvojën e vizitorëve, rrit kohën e qëndrimit cilësor të tyre dhe ndikon në uljen e sezonalitetit të aktivitetit turistik në dobi të rritjes së punësimit dhe zhvillimit social e ekonomik.



Përmes kësaj ideje, janë realizuar 4 shtigje të gjëlberta, është krijuar harta digjitale e cila përmban shënjimin me GPS, pikat e interesit dhe informacionin e nevojshëm të shtigjeve.

Realizimi i këtyre shtigjeve pritet të nxisë banorët e 8 fshatrave të përfshira në itineraret e tyre, që të përshtasin shtëpi pritëse për të ofruar akomodim e shërbime për vizitorë, si dhe të shtojnë prodhimin e produkteve tipike lokale që mbështeten në lëndën e parë të siguruar nga natyra.



4

PUNËSIM I
DREJT PËRDREJTË

4

PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME

5

BASHKËPUNIME

PEMLA LIVING FOODS

pemla.al

pemla.al

pemla.al



Sipërmarrja sociale e ngritur nga Ana Shima nëpërmjet Pemla sh.p.k, synon të prodhojë gjalpë arre në mënyrë artizanale me cilësi të lartë duke përdorur përbërës lokalë, si dhe të stimulojë zhvillimin ekonomik të zonave rurale përmes promovimit të kultivimit të pemës së arrës dhe farave vajore.

Liçencuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), biznesi prodhon gjalpë arre, lajthie dhe gjalpë bajameje me përbërës lokalë. Produktet janë të pranishme në më shumë se shtatë supermarkete dhe dyqane ushqimesh të shëndetshme në Tiranë. Kërkesa për këto produkte është në rritje ndaj sipërmarrja sociale po planifikon të zgjerohet dhe në qytete të tjera.



Pemla.al ka trajnuar dhe punësuar dy gra nga grupe të marginalizuara dhe Komuniteti Rom. Për më tepër, biznesi ka krijuar bashkëpunim me fermerë vendas për blerjen e lëndës së parë për prodhimin e gjalpë të arrave. Deri tani janë krijuar 67 mundësi bashkëpunimi.



4

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË
2 FEMRA**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

3

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME
DHE VULLNETAR**

3

BASHKËPUNIME

TRYEZA E SHIJES

[gendra_per edukim_kulinar](#)

[gendraperedukimkulinar](#)

[gek.al](#)



Tryeza e Shijes është një ide biznesi e zbatuar nga Qendra për Edukim Kulinar. Kjo sipërmarrje sociale promovon gatimet tradicionale shqiptare dhe produktet lokale në një mjedis gjithë-përfshirës. Risia qëndron në faktin se të gjithë mysafirët dhe klientët janë të ulur në të njëjtën tavolinë, e mbiquajtur si Tavolina Sociale, në mënyrë që të ndajnë përvoja të ndryshme së bashku dhe të bisedojnë me njëri-tjetrin.



Të gjitha produktet e kuzhinës përgatiten nga 8 të rinj dhe të reja nga grupe të marginalizuara, të cilët u trajnuan nga shefat më profesionistë dhe janë tanimë pjesë e kësaj iniciative.

“Tryeza e Shijes” ndodhet në Tiranë dhe prej ditës së inaugurimit të saj në Tetor 2019, ka organizuar mbi 21 tavolina sociale me të ardhura rreth 10,000 Euro. Restoranti ndjek udhëzimet e HACCP (Analiza e Rrezikut dhe Pikat e Kontrollit Kritik) lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe proceset ricikluese.



9

PUNËSIM I DREJT PËRDREJTË

6

PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

33

PUNËSIM ME KOHË TË PJESSHME DHE VULLNETAR

22

BASHKËPUNIME

PEDALO NË BELSH

[pedalo.ne.belsh](https://www.pedalo.ne.belsh)

[pedalonebelsh](https://www.pedalonebelsh)

[belshbike.al](https://www.belshbike.al)



“Pedalo në Belsh” e zbatuar nga Albert Hysa, është një shërbim biçikletash me qira në qytetin e Belshit. Përveç promovimit të bukurive natyrore të zonës duke eksploruar të 84 liqenet me biçikletë, kjo nismë synon të krijojë një kulturë pedalimi, si një mënyrë e shëndetshme jetese për të rinjtë dhe jo vetëm. Gjithashtu, sipërmarrja përcjell mesazhin tek të rinjtë për të mos emigruar, por për të investuar dhe për tu angazhuar në komunitetet lokale duke gjeneruar të ardhura për veten dhe familjet e tyre.



Tre të rinj janë trajnuar dhe punësuar përmes këtij biznesi lokal. Gjatë gjysmës së parë të vitit të operimit, dyqani numëroi mbi 1,600 klientë dhe një fitim prej afërsisht 136,000 Lekë. Në vijim biznesi synon të rrisë numrin e biçikletave për t’iu përgjigjur kërkesës së lartë.

Pedalo në Belsh është mbështetur serish nga Partnerët Shqipëri nëpërmjet Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta 2022, me zhvillimin e idesë për përdorimin e motorëve elektrikë city-coco.



3

PUNËSIM I DREJT PËRDREJTË

3

PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

1

PUNËSIM NGA KOMUNITETI ROM

1

BASHKËPUNIME

MARGJELO FILIGRAN ALBANIA



margjelo_filigran.albania



[/Margjelo-Filigran-Albania](https://www.facebook.com/Margjelo-Filigran-Albania)



margjelofiligran.com



Margjelo Filigran Albania e ngritur nga Aurora Piranej, është një sipërmarrje e re e cila synon rritjen e aftësive dhe punësimin e grave artizane të qytetit të Shkodrës, në procesin e përpunimit të metalit të argjendit me teknika artizanale si filigran, thurje apo punime me grep për të prodhuar objekte të ndryshme dekorimi, suvenire dhe bizhuteri.

Aktualisht, sipërmarrja ka të punësuar 3 punonjës me kohë të plotë dhe po bashkëpunon me 2 piktorë për dizejnimin e produkteve duke ndërthurur tradicionalen me modernen.



4

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

19

BASHKËPUNIME

RINORA HANDMADE

[rinorahandmad](#)

[rinorahandmade](#)



Rinora Handmade është një sipërmarrje e ngritur nga Rakip Belishaku, e cila fokusohet në prodhimin e sapunëve artizanale dhe sfungjerit bimor “Made in Albania” duke i ofruar konsumatorëve një produkt natyral prodhuar nga lëndët e para të vendit tonë.

Sipërmarrja ka punësuar 3 gra me kohë të pjesshme për mbledhjen e lëndës së parë të sfungjerit, si dhe bashkëpunon me fermerë lokalë për sigurimin e bimëve aromatike si lëndë të parë.



Si pjesë të përgjegjësisë sociale të biznesit, 10% e të ardhurave nga shitja e çdo produkti Rinora Handmade shkon për mbështetjen e grave dhe fëmijëve viktimë të dhunës.

Rinora Handmade ishte një nga pesë bizneset fituese në konkursin rajonal të bizneseve të gjelbërta #BGI2020, ku konkurruan 21 sipërmarrës nga Ballkani për fonde shtesë.



2

PUNËSIM I DREJT PËRDREJTË

1

PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

2

PUNËSIM ME KOHË TË PJESSHME DHE VULLNETAR

10

BASHKËPUNIME

PRODIMI I VAJIT TË LAJTHISË



hazeland.al

[hazelandfarm](https://www.facebook.com/hazelandfarm)



Kjo sipërmarrje e re e drejtuar nga Julvin Marku, përveç sjelljes në treg të këtij produkti të përpunuar nga fruti i lajthisë, synon gjithashtu të nxisë bashkëpunimin me fermerë të tjerë të fshatit Gramëz në Thumanë, për të siguruar prej tyre frutin e lajthisë si lëndë të parë për prodhimin e vajit.

Prej mbështetjes nga Partnerët Shqipëri, sipërmarrja punësoi 4 punonjës sezonalë, të cilët u angazhuan në vjeljen e frutit dhe ofrimin e vajit të lajthisë në treg në dhjetor të vitit 2020.

Përveç ofrimit të vajit të lajthisë, sipërmarrja ka zgjeruar ofertën e produkteve duke shtuar dhe lloje të tjerë arroresh, duke e kthyer në një fermë lajthish.



3

**PUNËSIM I
DREJT PËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

3

BASHKËPUNIME

KROI I MJALTIT

kroi_mjaltit



Kroi i Mjaltit është një sipërmarrje e ngritur nga Besart Lama. Ajo fokusohet në prodhimin dhe tregtimin e mjaltit dhe nënprodukteve të tij.

Brenda një kohe të shkurtër, përmes mbështetjes së ofruar nga Partnerët Shqipëri, sipërmarrja rriti prodhimin e produkteve të mjaltit me 40%, duke ndikuar në rritjen e punësimit lokal dhe rendimentit të prodhimit të kulturave bujqësore të fshatit Shullazë të Kurbinit.



2

PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË

1

PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME

2

FURNITORË

ROMIX COMMUNITY TOYS



romix.comics

[CommunityComics](https://www.facebook.com/CommunityComics)

romix.al



Romix Community Toys është markë e ngritur në vitin 2021 nga Xhenson Çela. Fillesat janë me botimin e librit të parë me histori comics për fëmijë dhe tashmë produktet janë diversifikuar në prodhimin e lodrave të thjeshta dhe unike me përmbajtje të materialeve të riciklueshme, kryesisht nga druri dhe copat e tekstit.



Një pjesë e të ardhurave të gjeneruara nga shitja përdoren si fond për të mbështetur iniciativa sociale.

Kjo sipërmarrje shërben si burim punësimi për të paktën tre (3) gra rrobaqepëse nga minoriteti rom dhe/apo nga grupet e tjera vulnerabël si dhe mbështet tregtarët nga këto komunitete duke siguruar prej tyre lëndën e parë.



4 PUNËSIM I DREJT PËRDREJTË NGA KOMUNITETI ROM

2 PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

2 PUNËSIM ME KOHË TË PJESSHME

2 BASHKËPUNIME

THESARET E SHIJEVE TË PËRMETIT



[thesaretshijevetepemetit](#)



[Thesaret-e-Shijeve-te-Permetit](#)



Thesaret e Shijeve të Përmetit, është ngritur nga Blerina Zyberi, përmes mbështetjes financiare të Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta. Ai vepron si dyqan-eksponitor për degustimin, shijimin dhe tregtimin e produkteve organike, tipike të zonës së Përmetit. Ky dyqan u ofron konsumatorëve produkte të shëndetshme, si dhe fermerëve, prodhuesve dhe amvisave ndihmë për shitjen e produkteve të tyre. Në dyqan shiten manaferra, thana, luleshtrydhe, boronica etj., si dhe një shumëllojshmëri me gliko, reçelra të ndryshëm, mjaltë, raki, verëra nga varietete të ndryshme të zonës, djathë i bardhë i deles, bimë mjekësore, bukë e bërë në mënyrë artizanale dhe byrekë me shije të ndryshme.

Kjo sipërmarrje synon të plotësojë eksperiencën e pushuesve dhe vizitorëve të qytetit të Përmetit në aspektin e gastronomisë organike dhe agroturizmit, me anë të ofrimit dhe servirjes në mënyrë unike të produkteve vendase.

Thesaret e Shijeve të Përmetit ishte një nga pesë bizneset fituese në konkursin rajonal të bizneseve të gjelbërta #BGI2021, ku konkurruan 21 sipërmarrës nga Ballkani.



3

PUNËSIM I DREJTPËRDREJTË

3

PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

34

BASHKËPUNIME

TURI I LAJTHIVE

[agrofermaxheviti](https://agrofermaxheviti.al)

[Agroferma-Xheviti](https://agroferma-xheviti.al)

agrofermaxheviti.al



Turi i Lajthive organizohet “Te Ferma e Xhevitit”, një biznes i ngritur në zonën e Mallakastrës nga Kreshnik Heqimaj, i përqendruar në kultivimin e produkteve të lajthisë dhe ullirit.

Turi i Lajthive, i organizuar në formë panairi, u shërben fermerëve të zonës për të shitur produktet e tyre gjatë periudhës së vjeljes, dhe ofron një eksperiencë unike për vizitorët që jo vetëm të blejnë produktet, por edhe të shohin nga afër procesin e vjeljes dhe korresjes së produkteve, duke u siguruar për cilësinë e tyre.

Përmes mbështetjes nga Partnerët Shqipëri, biznesi synon të përmirësojë këtë eksperiencë të konsumatorëve, të rrisë gamën e nënprodukteve, si dhe të investojë në një paketim cilësor të produkteve.



2

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

17

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME
DHE VULLNETAR**

4

BASHKËPUNIME

SHEBENIK EGNATIA EXPLORERS



[shebenik-egnatia-explorers](#)



[Shebenik-Egnatia-Explorers](#)



[shebenik-egnatia-explore.com](#)



Ideja ka të bëjë me ngritjen e kampeve në Parkun Kombëtar të Shebenikut dhe në segmente të veçanta të rrugës Egnatia. Ideuesi, Lytifi Alliu, ka një eksperiencë 2-vjeçare në organizimin e tureve të ndryshme në Park dhe në Rrugën Egnatia.

Parku i Shebenikut është parku kombëtar më i madh në Shqipëri, i përbërë nga fshatra të ndryshëm, të cilët fatkeqësisht janë në prag të braktisjes. Eksplorimi i të gjithë zonës së parkut dhe atraksioneve të ndryshme të tij kërkon kohë. Prandaj, ideja konsiston në shfrytëzimin e kampeve për të vizituar sa më shumë destinacione, duke shërbyer edhe si një mundësi argëtimi për turistët. Në të njëjtën mënyrë, kampet do të jenë jo vetëm një vend që do t'u ofrojnë turistëve akomodim, por ato janë konceptuar si të përbëra nga një shumëllojshmëri aktivitetesh, duke përfshirë lojëra, vrojtimin e yjeve me teleskop, shijimin e ushqimeve tradicionale vendase dhe organizimin e tureve me biçikletë.



Ndër të tjera, për t'u përmendur janë: ngjitje 'hiking', kampe malore 2-3 ditore, ture historike, aktivitete ndërgjegjësuere dhe kampe të studentëve, si dhe seanca trajnimi me specialistë të mjedisit apo fushave të tjera.



5

**PUNËSIM I
DREJT PËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

4

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

5

BASHKËPUNIME

FUNKY CABINS GLAMPING

[funkycabin2021](#)

[funkycabin2021](#)

[funky.al](#)



FunkyCabins është konceptuar si një hotel me 5 yje në natyrë, ofruar nëpërmjet kabinave ekologjike prej druri, të pajisura xham që lejojnë një fushëpamje 360°. Ideja është projektuar nga Rizvan Kurti dhe në të kombinohen kampingu tradicional me komoditetin e akomodimit në hotel. Kabinat ngjasojnë me tentat indiane dhe janë tërësisht të vetë-qëndrueshme, duke operuar përmes sistemit të tyre të energjisë elektrike, banjës ekologjike dhe pajisjes me internet Wi-Fi. Dizajni i brendshëm i çdo kabine mishëron elemente minimaliste dhe tradicionale. Përdorimi i qilimave tradicionale, tavolinave të ulëta dhe dritave të qiririt krijojnë një atmosferë shumë komode dhe të ngrohtë.



FunkyCabins është një hotel ekologjik për shërbime turistike, i projektuar për të shërbyer në zonat më të thella dhe të largëta të vendit. Komunitetet lokale përfitojnë në punësim dhe shërbime plotësuese. Që nga vendosja e kabinave në Liqenin e Çekrezit, rruga është sistemuar, disa lokale të zonës janë afëruar dhe i janë bashkuar nismës, në tokën dhe shërbimin hotelier të kabinave tashmë janë të punësuar më shumë se 4 familje, ku përfshihen gratë dhe burrat e këtyre familjeve.



3

**PUNËSIM I
DREJT PËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

2

BASHKËPUNIME

BELSH SMART CITY

[pedalo.ne.belsh](https://www.pedalo.ne.belsh)

[pedalonebelsh](https://www.pedalonebelsh)

[belshbike.al](https://www.belshbike.al)



Biznesi “Pedalo në Belsh” është një start-up i ngritur nga Albert Hysa, i mbështetur financiarisht nëpërmjet Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta në vitin 2019, i cili vazhdon aktivitetin duke mundësuar punësimin e dy personave.

Ideja “Belsh Smart City” ka të bëjë me zgjerimin e shërbimit, duke sjellë motorë elektrikë ‘City-Coco’, të cilët janë mjaft të preferuar nga të rinjtë por jo vetëm, si një mënyrë për të rritur pjesën e tregut dhe për të gjeneruar të ardhura shtesë. Motorët janë pozicionuar në sheshin e qytetit ku biznesi ushtron aktualisht aktivitetin e tij të dhënies së biçikletave me qira, duke krijuar kështu një shërbim krejt të ri brenda tij, i cili vjen si zgjidhje për vizitorët që duan të vizitojnë destinacionet turistike në Belsh, por edhe për vetë banorët.

Ndikimi pozitiv i iniciativës pritet në mjedis, në punësimin e drejtpërdrejtë dhe kontributin në ekonominë e zonave përreth liqeneve të Belshit, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për turistët dhe vizitorët.



3

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

3

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

1

**PUNËSIM NGA
KOMUNITETI ROM**

1

BASHKËPUNIME

LIKA API-TURIZËM

[sebishtiguesthouse](#)



Ideja konsiston në kthimin në njësi akomoduuese të ambientit, në të cilën Fiqiri Lika vazhdon traditën familjare si bletë-rritës kuangazhohet për pritjen e turistëve në fshatin Sebisht. Ai synon të maksimizoje eksperiencën e turistëve nëpërmjet aktiviteteve që ata dëshirojnë të kryejnë gjatë akomodimit në shtëpi, si ofrimi i ushqimeve të fshatit, si dhe përfshirja e tyre në procesin e mbarështimit të bletëve si ushqyerja, roitja, vjelja e mjaltit, dhe kujdesi ndaj bletës, i quajtur ndryshe “Api-turizëm”.



Fshati Sebisht është një vend turistik përrallor, por në të ende nuk ka shtëpi pritëse, bujtinë, apo njësi akomoduuese për vizitorët. Shërbimet ofrohen në formën e paketave turistike, në të cilën përfshihet akomodimi dhe shoqërimi në aktivitete brenda njësisë dhe në natyrë. Po ashtu, do të vazhdojë shitja e produkteve si: arrat, oshafi i kumbullës, rakia, komposto e thanës dhe qershisë, mjalti dhe shumë produkte të tjera organike, të cilat prodhohen dhe tregtohen aktualisht, duke eliminuar kostot e transportit për dërgimin e tyre në qytet.

Ideja mbështetet mbi traditën lokale dhe sjellja dhe qëndrimi i vizitorëve në fshat sjell impakt ekonomik pozitiv dhe në ekonominë e banorëve të tjerë, nëpërmjet shitjes së produkteve dhe shërbimeve të turistët.



3

PUNËSIM I DREJTPËRDREJTË

1

PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

2

PUNËSIM VULLNETAR

3

BASHKËPUNIME

PURTEKA. KOPSHTARIA PËR FËMIJË



[purteka](http://purteka.com)



Idea e biznesit konsiston në ngritjen e një dyqani “shëtites” për shitjen e produkteve si: libri “Kopshtaria për fëmijë” me autore vetë sipërmarrësen, që përmban projekte për mbjelljen e 38 bimëve në vazo e në kushte shtëpie; paketa me fara bimësh të konsumueshme, shoqëruar me udhëzues për tu përdorur nga fëmijët në kushtet e shtëpisë; si dhe objekte të tjera kopshtarie si çanta ‘tote’, ujitëse, hotele bletësh, ushqyese të zogjve të lirë, fidanë lulesh, perimesh e pemësh, etj. për të plotësuar kështu gamën e një dyqani.



Idea është konceptuar nga Marcela Tringaj, e cila nisur nga praktika dhe identifikimi i hendekut në kurrikulat mësimore për aftësimin e fëmijëve për kultivimin e bimëve, ka si qëllim shëtitjen në lagjet kryesore të qytetit, sheshet, bulevardet, kopshtet e shkollat, duke bërë që karrociera të shndërrohet jo vetëm në dyqan, por edhe një hapësirë për projekte falas për fëmijët.

Nëpërmjet këtij lloj produkti dhe shërbimi, që përbën një risi për tregun në Shqipëri, kjo sipërmarrje e gjelbër prek dhe ndikon në një sërë fushash të ndjeshme: bujqësia e qëndrueshme, edukimi, qytetet e qëndrueshme dhe ekonomia qarkulluese.



1 PUNËSIM I DREJT PËRDREJTË

1 PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

11 BASHKËPUNIME

AMËZA E DHEUT

ameza e dheut



Ideja e Leonida Palushaj konsiston në krijimin e një punishteje për përgatitjen e produkteve të qeramikës, e cila do të shërbejë si një hapësirë komunitare për organizimin e klasave rezidenciale, kurseve apo klubeve për fëmijë dhe të rritur, duke përfshirë dhe njerëzit me aftësi ndryshe fizike, të cilët mund të ndërveprojnë, të mësojnë një aftësi të re dhe të zhvillojnë kreativitetin e tyre. Ajo do të shërbejë si katalizator për rikthimin e vëmendjes në njohuritë e përpunimit të baltës dhe qeramikës dhe rëndësinë e përcjelljes së saj tek brezat e rinj, si dhe do krijojë mundësi për gjenerim të ardhurash duke plotësuar edhe më mirë produktin turistik të zonës. E veçanta tjetër lidhet me turizmin e eksperiencës, ku turistët do të përfshihen në proceset e përpunimit të baltës për krijimin e produkteve të cilat mund t'i marrin me vete.



Objektivat janë: ruajtja e njohurive për përpunimin e baltës dhe artit të poçerisë; promovimi i vlerave autentike, përmes produkteve të punuara në mënyrë artizanale dhe me material të riciklueshëm, nëpërmjet ekonomisë qarkulluese; ofrimi i mundësive të zhvillimit njerëzit me aftësi ndryshe fizike dhe që për pasojë vazhdojnë të mos përfshihen në tregun e punës.



1

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

BASHKËPUNIME

MJEDRAT E DANJËS

mjedrat.e.danjes



Ideja konsiston në kultivimin e frutit të mjedrës, duke sjellë kështu një produkt të ri për zonën e Vaut të Dejës, e duke ofruar për konsumatorin një frut organik të certifikuar sipas standardit “Organic”, me vlera të larta ushqyese.

Ideja është sjellë nga Sentiljana Marku, e cila ka si qëllim që të jetë fermerja e parë që angazhohet në kultivimin e Mjadrës në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës dhe në qarqet e Shkodrës dhe të Lezhës.



Objektivat afatshkurtër lidhen me ringritjen, sistemimin e fermës dhe tregtimin e produkteve, ndërkohë që ndër objektivat afatgjatë renditen: shtimi i plantacionit të mjedrave, ngritja e një dhome frigoriferike për ruajtjen dhe konservimin e produktit, zgjerimi i aktivitetit në Qarkun e Shkodrës dhe atë të Lezhës, si dhe diversifikimi i mëvonshëm i produktit të mjedrës, i quajtur ndryshe dhe si “Ari i kuq”.



Grupi i synuar i klientëve janë individët si dhe bizneset, duke përfshirë dyqanet e ëmbëlsirave, dyqane me produkte organike, supermarketet, restaurantet, si dhe njësitë e sektorit të agroturizmit në zonën përreth.



3

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

REALITY ESCAPERS ALBANIA

 2023

realityescapersalbania

realityescapersalbania

escapersal.com



Reality Escapers Albania është një operator turistik që ofron shërbime kryesisht në sportet në natyrë, si ecje malore, kampet, vëzhgimi i shpendëve dhe turet me kajak në zonat përreth Vlorës.



Ideja zbatohet nga Ornold Bazaj, i cili nisur nga eksperiencia e gjatë në sektorin e turizmit dhe kontakti i drejtpërdrejtë me turistët vendas dhe të huaj, ka identifikuar si problematikë mungesën e diversifikimit të ofertës turistike në Vlorë, për sa i përket ekzistencës së shërbimeve të reja dhe mundësive të zgjedhjeve për të eksploruar, zbuluar dhe shijuar sportet në natyrë, lidhur ngushtësisht dhe me traditën dhe kulinarinë vendase; sezonalitetin e shkurtër turistik; por dhe mungesën e sigurisë, kryesisht përgjatë aktiviteteve malore. Do të ofrohet si shërbim i ri turet “hiking” në majën e Çikës, gjiret fantastike dhe të egra të Gadishullit të Karaburunit, shpellat ujore; lundrimin me kajak, si dhe vëzhgimin e shpendëve. Aktivitetet turistike do të zhvillohen sipas standardeve evropiane dhe botërore edhe përgjatë dimrit, çka do të ndikojë në shtrirjen e sezonit turistik, si dhe krijimin e pikës së parë “Adventure Point” në Shqipëri.



2

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

TRENDY TRADITË

[trendy_tradite](#)

[Trendy tradite](#)



Ideja 'Trendy Traditë' konsiston në ruajtjen e kulturës e traditës lokale përmes veshjeve tradicionale të zonës së Vaut të Dejës, dhe promovimin e punës artizanale e kalimin e saj tek brezi i ri.



Ideja zbatohet nga Marjana Jakini, e cila vazhdon traditën e punës në rrobaqepësi, të transmetuar që në vogëli nga halla e saj. Synimi është ruajtja dhe avancimi i kësaj tradite, si dhe ofrimi i modeleve të reja ku ndërthuren elementët tradicionale me ata bashkëkohorë, sipas nevojave dhe kërkesave të klientëve, duke e kthyer biznesin në një aset për zonën.

Mbështetja nga Konkursi do të shkojë për investim në makineri dhe pajisje, si një mënyrë për të lehtësuar punën e grave të përfshira të komunitetit lokal, duke ndikuar në uljen e kostos së punës dhe rritjen e cilësisë dhe ofertës së produkteve.



2

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

FERMA E KËRPUDHAVE




Ideja konsiston në ngritjen një ferme me kërpudha, me vizionin për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë urbane nëpërmjet kultivimit të kërpudhave, të cilat shërbejnë si një produkt me vlera ushqimore, i sigurt, dhe i prodhuar në vend. E themeluar nga Rexhina Gjolla, misioni i saj është adresimi i kërkesës në rritje për prodhime të freskëta organike, duke përdorur praktika në mbrojtje të mjedisit.

Objektivat kryesore janë: (i) Ofrimi i kërpudhave të freskëta dhe të sigurta për konsumatorët shqiptarë; (ii) Kontributi në reduktimin e gjurmës së karbonit nëpërmjet praktikave lokale të kultivimit; (iii) Fuqizimi i individëve për t'iu afuar bujqësisë dhe ndërgjegjësimi për lidhjen më të thellë me praktikatat e shëndetshme për të mirën e komunitetit. (iv) Kontributi në edukimin e konsumatorëve në lidhje me përfitimet shëndetësore dhe rëndësinë e teknikave të kultivimit të sigurt.

Klient është çdo individ i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë ndaj mjedisit, entuziastët e shëndetit, eksploruesit e kuzhinës, organizatat, komunitetet që vlerësojnë produktet ushqimore të sigurt, organik dhe vendas.

Mbështetja nga konkursi do të shërbejë për mbulimin e kostove fillestare të startup-it në lidhje me materialet, mjetet dhe pajisjet.



3

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME
DHE VULLNETAR**

AGALMA SUSTAINABLE SOUVENIRS



laser.studio.agalma



Agalma Sustainable Souvenirs prodhon suvenire miqësore me mjedisin, duke përfshirë shënjes librash, magnetë për frigoriferin dhe slitë, që festojnë trashëgiminë e pasur kulturore të Shqipërisë dhe figura të njohura globalisht.

Ajo u themelua nga Ermal Çukani, me vizionin për të prodhuar suvenire inovative dhe të personalizuar eko-miqësore. Produktet janë krijuar nga materiale të qëndrueshme ose 100% natyrale, të tilla si tapa dhe derivatet e drurit miqësor ndaj mjedisit, pa përdorur ngjyrues ose aditivë.



Gjatë prodhimit përdoret teknologjia e gdhendjes me lazer, për të siguruar ndikim minimal mjedisor dhe ruajtur vlerën kulturore. Unike në vendin tonë dhe me gjasë edhe më gjerë, suveniret janë të dekoruara nga të dyja anët, ndërsa Agalma është e specializuar në suvenire të personalizuar për hotele dhe biznese, duke përfshirë logot dhe kodet 'QR'. Për të shfaqur krijimet në këto biznese, është krijuar 'Agalma Box'.

Shqipëria promovohet nëpërmjet personazheve shqiptarë që kanë pasur ndikim botëror dhe monumenteve të rëndësishëm të vendit, me një qasje inovatore në paraqitjen e mesazheve.



2

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME
DHE VULLNETAR**

SHEBENIK EGNATIA EXPLORERS



[shebenik_egnatia_explorers](https://www.instagram.com/shebenik_egnatia_explorers)



[Shebenik-Egnatia-Explorers](https://www.facebook.com/Shebenik-Egnatia-Explorers)



[shebenik-egnatia-explore.com](https://www.shebenik-egnatia-explore.com)



Shebenik Egnatia Explorers është një biznes i ngritur nga Lytfi Alliu, mbështetur fillimisht nëpërmjet Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta 2022.

Ideja e re konsiston në zhvillimin dhe zgjerimin e kampeve lëvizëse në Parkun Kombëtar Shebenik, si dhe në segmente të rrugës Egnatia, me synim përmirësimin e shërbimeve të ofruara, gjallërimin e jetës në park dhe ofrimin e eksperiencës unike të vëzhgimit të yjeve me teleskop, duke kulmuar në eventin më magjik të “Shiut të Yjeve Perseid”, i cili mund të vëzhgohet në Shqipëri vetëm në Shebenik.



Mbështetja nëpërmjet konkursit do të shkojë për shtimin e kapaciteteve të çadrave, dyshekëve dhe fjetjes, si dhe për pajisjen me teleskop dhe mjete cilësore të ofrimit të shërbimeve.

Tashmë ekipi përbëhet nga 4 persona dhe është mundësuar bashkëpunim me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë dhe Administratën e Zonave të Mbrojtura Elbasan si dhe Drejtorinë e Turizmit në nivel të pushtetit vendor.



5

PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË

1

PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË

4

PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME

5

BASHKËPUNIME

MJEDRAT E DANJËS SCALE-UP

mjedrat.e.danjes



Mjedrat e Danjës është një biznes i ngritur nga Sentiljana Marku, i mbështetur fillimisht përmes Konkursit të Bizneseve të Gjelbërta 2022.

Mbështetja nga konkursi këtë vit do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të fermës, për t'u bërë fermerja e parë femër në territorin e Bashkisë Vau i Dejës, si dhe në qarkun e Shkodrës dhe atë të Lezhës për kultivimin e mjedrës, ose siç quhet "Ari i Kuq". Synimi është diversifikimi i produktit, shtimi i plantacionit dhe kthimi në pikë grumbullimi për të dy qarqet.



Zgjerimi i fermës do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në komunitetin lokal, ku fillimisht do të punësohen dy punonjëse femra me bazë sezonale dhe një punëtorë ndihmëse për të kryer punë të specializuara në fermë. Pritet që në të ardhmen, me zgjerimin e mëtejshëm të fermës, të rritet edhe numri i të punësuarve, duke pasur fokus të drejtpërdrejtë në grupet më pak të favorizuara.



3

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

PURE RECALL

handmade.jorean



“Pure Recall” nga Jorean Handmade është një markë shqiptare që përqendrohet në vlerësimin e bukurisë natyrore përmes edukimit dhe përdorimit të produkteve lokale për kujdesin personal, që janë miqësore me mjedisin. E themeluar nga Alketa Muharemi në Vlorë, ajo prodhon një gamë produktesh kozmetike dhe higjienë personale, të përbëra nga produkte organike lokale, duke si: sapunë të ngurtë dhe të lëngshëm; balsame shëruese për probleme të ndryshme të lëkurës; kremra për duar, këmbë dhe trup; pastrues dhe shumë të tjerë.

Sapunët artizanale, duke qenë unikë dhe të veçantë, ashtu si secili prej nesh, janë të dizenuar dhe përshtatur sipas nevojave specifike të lëkurës sonë, pas një periudhe testimi 3-vjeçare. Ato prodhohen duke përdorur lëndë të para nga burime lokale, ku 80% e përbërësve blihen nga fshatrat në rrethin e Vlorës, një zonë e pasur me vaj ulliri, dyllë blete, qumësht dhie dhe bimë aromatike dhe meqësore si rozmarinë, hithër, livando, nenexhik, sherebelë, dafinë, aloe vera dhe bimë të tjera. Kjo krijon një ndikim të drejtpërdrejtë dhe një vlerë të shtuar për ekonominë tonë lokale. Sapunët janë 100% të biodegradueshëm; ndërsa paketimi i tyre është ekologjik, i përbërë nga letër që është 100% e riciklueshme.

Mbështetja do të shkojë për blerjen e pajisjeve dhe aparatave për hapësirën e dedikuar për shitjen e produkteve dhe punishten.



3

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

2

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME**

15

BASHKËPUNIME

GREEN SOUND SPACE

musicapitol.al



“Green Spund Space - Art dhe tinguj për mbrojtjen e mjedisit” është prezantuar nga Gerald Taho, duke synuar fuqizimin e të rinjve të grupeve të marginalizuara, gratë dhe vajzat, nëpërmjet ofrimit të aksesit në edukim profesional muzikor, nxitjes së talentit krijues dhe promovimit të praktikave miqësore me mjedisin në prodhimin e muzikës.

Duke përdorur artin dhe muzikën për mbrojtjen e mjedisit, ideja e biznesit synon të shndërrojë studion muzikore të regjistrimit dhe prodhimit audiovizual Capitol në një qendër kreative të gjelbër (green co-space), që ndërthur artin, teknologjinë dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Duke rikonstruktuar hapësirën ekzistuese në një ambient të menaxhuar në mënyrë ekologjike dhe multifunksionale, ajo synon të krijojë një mjedis ku artistët, të rinjtë dhe komuniteti gjejnë mundësi për të krijuar, regjistruar, ekspozuar dhe ndarë përmbajtje me ndikim kulturor dhe social, sipas një qasje miqësore ndaj mjedisit.

Green Sound Space synon të adresojë jo vetëm mungesën e hapësirave të dedikuara për art dhe teknologji në komunitet, por edhe të kontribuojë në fuqizimin ekonomik dhe përfshirjen sociale të grupeve në nevojë, veçanërisht vajzave dhe grave, të rinjve dhe komuniteteve të marginalizuara (komuniteti Rom).



4 PUNËSIM I DREJTPËRDREJTË I SYNUAR

+50 ARTISTË KANË AKSES NË PAJISJE (SYNIMI)

15 BASHKËPUNIME TË SYNUARA

GREEN ENERGY

[fabrike_vaj_ulliri_alsa](#)

[Fabrikë Vaj Ulliri ALSA](#)



Fabrika e vajit të ullirit ALSA, një biznes i vogël familjar në Fier-Shegan, Lushnjë, që drejtohet nga Alvin Gjata, vepron në sektorin agro-përpunues duke përdorur linjën 3-fazore për përpunimin e ullirit.

Mbështetja nga konkursi konsiston në instalimin e një sistemi fotovoltai (energji diellore) mbi çatinë e fabrikës, për të mbuluar të gjithë nevojën vjetore për energji dhe për të injektuar energjinë e tepruar në rrjetin elektrik. Investimi do të mundësojë zëvendësimin e energjisë konvencionale me energji të rinovueshme, do të ulë ndjeshëm kostot e operimit, si dhe do të përmirësojë ndikimin mjedisor të fabrikës.

Përmes përfshirjes së parimeve të ekonomisë qarkulluese, përpunimit me energji të pastër dhe ndërtimit të një identiteti tregtar me rrënjë në komunitet, ALSA po formon një model biznesi që është i aplikueshëm në zona të tjera rurale. Kjo e pozicionon ALSA-n jo vetëm si një fabrikë prodhimi, por si një agjent pozitiv ndryshimi në Myzeqe, një model i biznesit të gjelbër rural, duke garantuar energji të pastër, të përbalueshme dhe të qëndrueshme.

ALSA bazohet në bashkëpunimin me fermerë të zonës, për përpunimin e ullinjve ose shitjen e tyre nëpërmjet marrëveshjeve të drejtpërdrejta. Synimi afatgjatë është kthimi i fabrikës në një hub komunitar dhe model bashkëpunimi, ku aktorët e zinxhirit të vlerës dhe fermerët të edukohen mbi cilësinë, përpunimin dhe prodhimin e një vaji cilësor që nxit ndërgjegjësimin dhe vlerën e shtuar.



8

**PUNËSIM I
DREJTPËRDREJTË**

1

**PUNËSIM ME
KOHË TË PLOTË**

3

**PUNËSIM ME
KOHË TË PJESSHME
DHE 4 BAZË VULLNETARE**

12

**BASHKËPUNIME
ME ENTITETE
DHE 160+ FERMERË**

VLORA KAYAKING

vlor_a_kayaking

[realityescapersalbania](https://www.realityescapersalbania.com)

[escapersal.com](https://www.escapersal.com)



Vlora Kayaking është një nismë e re e Reality Escapers Albania, që synon zhvillimin e sportit të kayaking-ut dhe turizmit aventurier në qytetin e Vlorës dhe zonat përreth. Ky sektor i dedikuar, i ndërmarrë nga Orndol Bazaj, synon të krijojë një eksperiencë të re për turistët vendas dhe të huaj, duke shfrytëzuar potencialin natyror të lumenjve Vjosa dhe Shushicë, lagunës së Nartës dhe vijës bregdetare të Vlorës.

Një nga shtyllat kryesore të Vlora Kayaking është përfshirja aktive dhe afatgjatë e komunitetit lokal, si në fazën operacionale, ashtu edhe në ndërtimin e vetë ofertës turistike. Nisma synon jo vetëm zhvillimin e turizmit sportiv, por edhe krijimin e një modeli të qëndrueshëm ekonomik për zonat rurale përreth Vlorës, me fokus të veçantë në luginën e lumit Vjosa dhe zonën e Shushicës.

Për më tepër, nisma krijon kërkesë të re për produkte dhe shërbime lokale, si produkte ushqimore artizanale, produkte bujqësore, mikpritje tradicionale dhe artizanat lokal, duke nxitur ringjalljen e vlerave kulturore dhe gastronomike të zonës.

Aktivitetet e Vlora Kayaking nuk janë vetëm një formë alternative rekreacioni, por një mjet për edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit dhe vizitorëve mbi rëndësinë e ruajtjes së mjedisit natyror dhe biodiversitetit lokal.



4

PUNËSIM I DREJTPËRDREJTË

1

PUNËSIM ME KOHË TË PLOTË

3

PUNËSIM ME KOHË TË PJESSHME

8

BASHKËPUNIME



Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

 www.partnersalbania.org

 Rruga e Elbasanit, Ndërtesa Park Gate, kati 10, ap. 71/73
Tirana, Albania